



LËVIZJE “GRASS-ROOT” LGTBI INKLUZIVE NË BAZA ETNIKE DHE GJINORE NË MAQEDONI



EKIPI KULUMTUES:

Dr. Katerina Kolozova

Dr. Kalina Lechevska

Dr. Viktorija Borovska

Ana Blazeva, MA

Përmbledhje e Përgjithshme

Projekti “Lëvizje “Grass-Root” LGTBI Inkluzive në Baza Etnike dhe Gjinore në Maqedoni”, i zbatuar me mbështetjen e Ambasadës së Mbretërisë së Holandës në periudhën prej shtatorit të vitit 2012 deri më shtatorin e vitit 2013, paraqet një studim politikash (policy study) për aktivitete që kanë për qëllim rritjen e vetëdijes publike.

Nevoja për një studim të këtillë buron nga gjendja e tanishme dhe pozita e personave LGBTI, si një nga grupet më të cënueshme në shoqërinë maqedonase. Praktikisht, nuk ka mbrojtje ligjore kundër diskriminimit të personave LGBTI, e as nuk ka politika institucionale egzistuese për inkluzionin/kyçjen e tyre shoqërore. Diskurs publik i arsyeshëm, i cili do të jetë i ndjeshëm për të drejtat njerzore të këtyre personave, gjithashtu mungon. Nga ana tjetër, deri para pak kohësh, brenda lëvizjes kishte mungesë dukshme të lezbikeve, të personave transgjinerë dhe të pakicave të tjera etnike.

Qëllimi kryesor ishte që të bëhej një projekt afat-gjatë i cili do të ndikojë në përf forcimin e kapaciteteve të lëvizjes LGBTI në Maqedoni në një kohë të karakterizuar me homofobi gjërësisht të shprehur, me gjuhë urretjeje dhe me sërë sulmesh fizike ndaj njerëzve LGBTI. Një nga motivet e hulumtimit ishte që të rrisë aktivizimin mes grupeve të “padukshme” në komunitetin LGBTI siç janë lezbiket, personat transgjinerë dhe personat gej nga etnitë e tjera.

Pjesa e hulumtimit përbëhet nga një kombinim i metodave kërkimore cilësore dhe sasiore. IShShH-Sh përmes formave të mbyllura të debateve (fokus grupeve, diskutimeve grupore) kontribuoi në rrjetëzimin mes organizatave formale dhe joformale të cilat punojnë në drejtim të LGBTI aktivizmit etnikisht inkluziv dhe pjesës së aktivizmit feminist-lezbik. Gjatë realizimit të projektit grupi joformal LezFem u formua si një grup i cili është i lidhur me punën e Qendrës LGBTI, e cili menaxhohet nga Komiteti Maqedonas i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut. Gjithashtu, organizata multi-etnike joqeveritare LGBT Junajted u bë një pjesë aktive dhe e gjallë e aktivizmit që nga vjeshta e vitit 2012 (u regjistrua në Maj të vitit 2012) dhe njëherit kontribuoi në realizimin e këtij hulumtimi.

Idea kryesore e projektit është që të inicojë diskutim mes vetë aktivistëve sa i'u përket nevojave në kuadër të lëvizjes përmes debateve në nivel “grass-root” (brenda për brenda komunitetit), si dhe për nevojat në një kontekst më të gjërë shoqëror. Njëri nga qëllimet ishte që të dizajnohet një qasje specifike për kontekstin e cila do të përforcojë komunitetin LGBTI. Aktivitetet e projektit duhet të rezultojnë në mobilizimin e komunitetit LGBTI në vend, kah një lëvizje më kumbuese/më të gjallë dhe më të informuar për çështje lokale/më të ndjeshme për kontekstin e cila do të vendosë prioritetet dhe forma të aktivizmit, të përshtatshme për specifikat shoqërore dhe kulturore të Maqedonisë.

Konteksti dhe Korniza Ligjore

Komuniteti LGBTI ballafaqohet me paragjykime shoqërore dhe ligjore, me sjellje homofobike e transfobike dhe diskriminim jo vetëm nga rrethi, por edhe nga institucionet kompetente, të cilat duhet të bëjnë të kundërtën. Njerëzit LGBTI nuk trajtohen si qytetarë me të drejta njerzore dhe liri të barabarta, ndërsa institucionet përkatëse nuk tregojnë interes që të ndryshojnë këtë gjendje.

Një nga problemet kyçe të komunitetit LGBTI, i cili u përcaktua si më i rëndësishmi nga ana e të anketuarëve, është përjashtimi i tyre nga Ligji për Parandalim dhe Mbrojtje nga Diskriminimi (Gazeta Zyrtare nr,50/2010)¹. “Orientimi seksual” si bazë për diskriminim nuk është përmendur as në “Strategjinë Nacionale për Barazi dhe Anti-Diskriminim (2012-2015) të miratuar nga Ministria për Punë dhe Politikë Sociale. E tërë kjo dëshmon se njerëzit LGBTI trajtohen si qytetarë të rendit të dytë dhe që shteti nuk bën asgjë për ti mbrojtur.

Barazia për të gjithë qytetarët, përfshirë edhe orientimin seksual, garantohej vetëm me disa ligje në Republikën e Maqedonisë, siç janë këto në vijim: *Ligji për Mbrojtjen e të Drejtave të Pacientëve*,² *Ligji për Shëndet Publik*,³ *Ligji për Arsim të Lartë*,⁴ dhe në *Kodin Etik për Shërbyes Publik*.⁵

Mosnjohja e orientimit seksual si bazë për diskriminim kritikohet vazhdimisht në raportet vjetore të progres raporteve të Komisionit Evropian për Republikën e Maqedonisë. Në Raportin për 2011ën theksohet se komuniteti LGBTI është subjekt i diskriminimit dhe damkosjes, dhe që ka nevojë urgjente për rritjen e vetëdijes jo vetëm në aspekt ligjor, por edhe sa i'u përket parimeve të respektit dhe tolerancës për dallimet.⁶

Vrojtimi se komuniteti LGBTI është pre e diskriminimit dhe damkosjes vazhdon të jetë çështje⁷ në konkludimet e Komisionit Evropian me rekomandimin se orientimi seksual-si bazë e posaçme, duhet të përfshihet patjetër në *Ligjin për Mos-Diskriminim*.⁸

Një vit më vonë, mbetet vërejtja se komuniteti LGBTI është pre e diskriminimit dhe damkosjes, në bazë të së cilës konkludimet e Komisionit Evropian theksojnë se *Ligji për Mbrojtje kundër Diskriminimit* duhet të përfshijë patjetër orientimin seksual si bazë më vete.

Organizata ndërkombëtare ILGA-Europe, e cila mbron të drejtat dhe interesat e personave LGBTI në nivel Evropian, boton një listë vjetore në lidhje me gjendjen e të drejtave e njerzore të personave LGBTI. Në Shqyrtimin Vjetor të 2013-ës, Maqedonia zë vendin e 43-të (nga gjithësej 49 shtete). Maqedonia ka arritur vetëm 13% të drejtave LGBTI në kategori si: Ligje për Anti-Diskriminim, mbrojtje nga krime urretje dhe gjuhë urretjeje, si dhe në respektimin e lirisë së shprehjes.⁹

Strukturat politike në Maqedoni nuk kanë aspak interes në përmirësimin e të drejtave dhe statusit të personave LGBTI. Shumë shpesh, orientimi seksual përdoret si metod për diskreditimin e kundërshtarëve politik dhe si i tillë është përdorur në zgjedhjet e fundit lokale.¹⁰

Një nga deklaratat më të komentuar të vitit të kaluar, e cila ilustron politikat aktuale të injorancës dhe agjendën homofobike të qeverisë, ishte deklarata e Ministrisë për Punë dhe Politikë Sociale, Spiro Risteski i cili tha se “martesa është bashkësi mes një burri dhe një gruaje dhe lëshime për këtë çështje nuk do të bëhen asnjëherë përderisa partia e tij do të jetë në pushtet”. Ministri gjithashtu shtoi se “për një fëmijë, që të zhvillohet në mënyrë të rregullt, duhet të ketë një nënë dhe një baba në kuptimin e mirëfillt dhe biologjik të fjalës.”¹¹

Kjo deklaratë u shfrytëzua në kampanjën e qeverisë për promovimin e vlerave familjare. Kampanjë kjo, për të cilën u shfrytëzuan gjysmë milion Euro nga buxheti i shtetit.¹²

Gjatë realizimit të projektit, sidomos pas hapjes së Qendrës së parë për Mbështetjen e LGBTI-ve në Çarshinë e Vjetër, kishte sulme të shpeshta të qendrës, një sërë kërcënimesh për jetë kundrejt aktivistëve LGBTI, përfshirë edhe sulm me gurë drejt shtëpisë së një aktivisti i cili bëri “coming out” publik (doli hapur se është gej). Mediat me ndikim, në janar të 2013-ës botuan lajm se OJQ-ët për të drejtat e LGBTI-ve janë duke përgatitur “Gej Paradë” në Shkup.¹³ Në vend të “Gej Pradës”, aktivistët organizuan “Javë Prajd-i (Krenarie)”-një manifestim me evenimente, si diskutime dhe projeksione filmash në lidhje me të drejtat e LGBTI-ve. Rrjetet sociale ishin përplot me komente negative dhe kërcënime. Gjithashtu, u planifikua “Kontra-Gej Paradë”¹⁴, një kontra-protestë kundër të imagjinuarës “Gej Paradë” e cila nuk ndodhi. Në të njejtën ditë (më 22 qershor 2013), Qendra për Mbështetjen e LGBTI-ve u sulmua me gurë nga 40 persona të maskuar të cilët u përpoqën të hynë në projektimin e një filmi gjatë “Javës së Prajd-it”.¹⁵ Kjo ngjarje u pasua nga kritika nga përfaqësuesit diplomatik në Maqedoni dhe nga një letër e “Human Rights Watch”,¹⁶ por vetëm Partia Liberale nga partitë politike maqedonase, dhanë deklaratë lidhur me këtë sulm.¹⁷

Përshkrim i problemeve huluntuese dhe gjetjeve

Studimi bazohet në nevojën për një integrim më të mirë (në bazë etnike dhe gjinore) në platformat advokuese të personave LGBTI, si dhe për një lëvizje më të organizuar dhe më të dukshme të LGBTI-ve në Maqedoni. Bazuar në hulumtimet e mëparshme, të zhvilluara nga anëtarët e IShShH-Shkup, parasupozimet tona nisëse ishin: (1) padukshmëria e personave LGBTI është rezultat i tërheqjes dhe vetëcensurimit të vetë anëtarëve; (2) frika nga ekspozimi publik në një shoqëri patriarkale; (3) perceptimi se OJQ-ët janë përgjithësisht të korruptuara dhe se i keqpërdorin vuajtjet e grupeve të prekura¹⁸ si dhe (4) bindja e përgjithshme se seksualiteti i secilit është çështje private e secilit e jo çështje politike e andaj edhe publike.

Gjatë fazave cilësore dhe sasimore të hulumtimit, projekti përfshiu njëqind persona LGBTI në Republikën e Maqedonisë. Për shkak të natyrës së ndjeshme të çështjes, deklaratat e tyre do të ngelen anonime. Pjesëmarrësit janë një grup reprezentativ sa i përket gjinisë; vendit të banimit; përkatësisë etnike dhe statusit shoqëror, ndërsa sa i përket moshës së tyre, ajo ishte e kufizuar nga 18-45 vjeç.¹⁹

Metoda kërkimore cilësore, përfshirë edhe histori gojore dhe fokus grupe u përdorën për target grupet e projektit: lezbiket, biseksualët/et, personat transgjinorë, dhe personat gej me përkatësi të tjera etnike.

Metodi kërkimor sasior (pyetësor) u zhvillua me një kampion/mostër reprezentativ/e nga lëvizja LGBTI, me qëllim që të përcaktohen problemet e përgjithshme dhe prioritetet.



I. Historitë Gojore

Historitë gojore si metoda për ndarjen e perceptimeve dhe përvojave intime të cilat vendosen mes hulumtuesit dhe të intervistuarit, na mundësojnë një njohje më të afërt me realitetin e përditshëm me të cilin ballafaqohen personat LGBTI,²⁰ sidomos lezbiket, personat transgjitorë dhe personat gej nga etnitë e tjera. Historitë gojore përfshinë nëntë lezbike, persona transgjitorë dhe persona gej nga pakicat etnike. Gjatë intervistave të gjata disa orëshe ata patën mundësinë që të krijojnë, fitojnë besim dhe të flasin në mënyrë intime për sfidat dhe problemet me të cilat ballafaqohen çdo ditë gjatë luftës së tyre aktiviste.

I.1 Gjetjet nga të Dhënat e Historive Gojore

Lezbiket të cilat morrën pjesë në historitë gojore nuk e kanë përshtypjen se janë të diskriminuara rëndë nga rrethi, sepse ato kanë arritur që të krijojnë një rreth të tyre me shokë/shoqe dhe miq/mikesha tek të cilët gjejnë mbështetje. Duke folur për familjet e tyre, disa nga ato kishin shembuj të prindërve që i mbështesin, madje edhe në aktivizmin e tyre LGBTI. Disa nga ato kanë “marrëveshje të heshtur” që të mos flasin hapur për intimitetin e tyre, dhe ato ndihen komod me këtë, por për po të njejtat arsye, disa nga ato kanë probleme. Shumica e vajzave ndihen të diskriminuara fillimisht si gra në një shoqëri patriarkale dhe ato e theksojnë nevojën për të luftuar më zëshëm për të drejtat e tyre. Sipas vajzave, një nga gjërat më të rëndësishme është të bërit “*coming-out*” (të dalin hapur se janë lezbike), sidomos për ato të cilat nuk kanë probleme me vetë-pranimin. Një gjë e këtille mund të duket inkurajuese për ata persona LGBTI të cilët jetojnë në vende më konzervative, e sidomos në vende rurale. Një nga problemet kyçe të cilët ato numëruan ishte “toleranca e fshehur” ndaj lezbikeve dhe trajtimi se ato janë mendjelehta/joserioze i cili ju jep ndjesinë e padukshmërisë shoqërore. Secila nga ato ndihet më e padukshme si komunitet në krahasim me meshkujt gej të cilët janë më të shquar por që grumbullojnë zemërim publik gjithashtu.

Sipas të intervistuarave femra, prioritetet e komunitetit LGBTI duhet të zbatohen në tre nivele. Niveli i parë është korniza ligjore- krijimi i një strategjie për anti-diskriminimin e personave LGBTI. Niveli i dytë është qasja korrekte e mediave kundrejt personave LGBTI (pa tituj senzacionalistë, fyerje, stereotipime, dhe gjuhë urrejtjeje), si dhe dukshmëri më të madhe në mediat më me ndikim të cilat shpesh janë politikisht jokorrekte. Niveli i tretë është përforsimi i komunitetit i cili nuk është i organizuar mirë dhe integrimi më i madh mes anëtarëve (nëpër klube, qendra formale dhe joformale për mbështetje, qendra strehimi etj.)

Edhe personat gej nga pakicat etnike i ndajnë të njejtat prioritetet si lezbiket dhe e theksuan momentin ekonomik si një nga arsyet kryesore pse personat LGBTI jetojnë jetë të dyfishtë në frikë të përhershme. Historitë e tyre gojore nxorën në pah shembuj për dhunë ekstreme dhe mostolerancë. Disa nga ata janë viktima të fyerjeve konstante verbale dhe sulmeve fizike, ndërsa disa nga ata kanë frikë për jetën ngaqë marrin shumë kërcënime për jetë nga “njerëzit e tyre”. Ata paraqiten si turp dhe zhgënjim i grupit të tyre etnik.

Personat transgjitorë të cilët morrën pjesë në këtë pjesë të hulumtimit thanë që ata janë grupi më i dëmtuar/më në disavantazh në shoqëri. Fillimisht, ata ballafaqohen me paragjykime të vazhdueshme nga njerëzit e tyre më të afërt, të cilëve ju nevojitet një kohë e gjatë që ti pranojnë ata, dhe së dyti, nga rrethi më i gjërë. Ata janë të ekspozuar para përqeshjes dhe keqkuptimeve për gjendjen e tyre e cila i çon ata në vuajtje mentale dhe tentativa për vetëvrasje. Përpos diskriminimeve të përditshme, ata ballafaqohen me diskriminim edhe nga institucionet (në ndë-

-rrimin e letrave të njoftimit, diskriminim nga sistemi shëndetësor i Maqedonisë i cili nuk mbështet operimet e tyre). Sipas personave transgjidorë, problemi më i madh është mentaliteti i njerëzve të cilët nuk arrijnë të kenë empati dhe të pranojnë “diçka që nuk mund të kuptohet”. Prioriteti i personave transgjidorë është që të ndryshohet korniza ligjore e cila për momentin nuk është në gjendje t’ju rregullojë nevojat bazë.

II. Fokus grupet

Pjesa cilësore e hulumtimit përfshiu tre fokus grupe- një me persona gej nga etnitë e tjera dhe dy me lezbike dhe biseksuale femra. Për fat të keq, personat transgjidorë nuk ndiheshin komod që të flasin hapur përpara të tjerëve për problemet e tyre, kështu që fokus grupi i planifikuar me ta nuk ndodhi.

Frika dhe mosbesimi, të pasqyruara në përgjigjet e tyre, e karakterizuan fokus grupin me persona gej nga pakicat etnike (ata flisnin vetëm për problemet e të “tjerëve”, e jo për vetëveten). Të gjithë burrat kanë ndjesinë se më së shumti diskriminohen nga grupi i tyre etnik, dhe në të njëjtën kohë, ata ballafaqohen me hipokrizinë e shoqërisë maqedonase. Anëtarët e grupeve të tjera etnike nuk ndjejnë dhembshuri ose ndonjë gjë tjetër për ta sepse ata nuk janë “njëri nga ata”.

Të dhënat e gjetura tregojnë se shqipëtarët ndjejnë diskriminimin më të keq nga të gjithë persoant gej, sepse nuk mund të gjejnë asnjë lloj mbështetjeje në shtëpi për shkak të religjiozitetit të lartë dhe besimit se secili duhet të ketë familje “normale” të veten. Personat shqipëtarë gej i cilësojnë personat maqedonas gej si “elitistë” të cilët veprojnë vetëm nëpër vendet urbane dhe nuk i kycin personat gej nga etnitë e tjera. Personat shqipëtarë gej mendojnë që njerëzit të cilat kanë më së pakti mbështetje duhet të kycen në agjendat e OJQ-ëve sa më parë të jetë e mundur.

Dukshmëri/vizibilitet i organizuar dhe veprim i përbashkët janë prioritetet e personave gej nga etnitë e tjera. Ata mendojnë se në Maqedoni “nuk ka komunitet LGBTI, vetëm persona LGBTI” dhe që “mardhëniet personale mes personave LGBTI duhet të ndërpresin së ndikuari kauzën e tyre të përbashkët dhe qëllimin e dobishëm shoqëror”.



Fokus grupet e lezbikeve dhe biseksualeve femra nxorrën në pah shumë shembuj të dhunës psikologjike dhe fizike kundrejt tyre, sidomos kundrejt atyre të cilat banojnë në qytete më të vogla. Ato thanë që problemi më i rëndë është në trajtimin joserioz por të “favorizuar” në kontekste të ndryshme. Lezbiket trajtohen si eksperiment i shkollës së mesme, si sjellje festash, si fazë tranzite dhe ato ballafaqohen me komente të ndyra që lidhen me imazhe të krijuara nga filmat porno. Gati secila e intervistuar tha që, në një pikë të jetës së tyre, ato marrim komente të llojit: “Me siguri egziston një burrë i vërtetë i cili mund të të kënaqë dhe të të ndryshojë”. Ato pajtohen se janë më të pranueshme sepse janë më të padukshme si komunitet. Nga ana tjetër, biseksualet femra ballafaqohen me shumë më shumë mosmarrveshje për shkak të “pozitës së tyre identitare të pakompletuar”.

Sipas lezbikeve dhe femrave biseksuale, mardhëniet mes personave LGBTI duhet të përmirësohen dhe përforcohen dhe pastaj të definojnë prioritete politike. Opinioni duhet të informohet për ta në mënyrë më objektive, dhe siguria e tyre patjetër të garantohet duke zbatuar “orientimin seksual” si bazë për diskriminim.


III. Sondazhi

Sondazhi u realizua me mbi 140 persona LGBTI nga e tërë Maqedonia dhe me bashkëpunim të Qendrës për Mbështetjen e LGBTI-ve. Qëllimi ishte që të fitojmë pasqyrë për qëndrimet e sa më shumë personave LGBTI në lidhje me çështjet kyçe dhe sfidat për komunitetin. Pyetjes së parë: “A jeni ndjerë ju, si person LGBTI, i/e diskriminuar?” i/u përgjigjën pozitivisht një shumicë dërrmuese prej 93%. Të tjerët të cilët përbënin 7%-in asnjëherë nuk kanë ndjerë asnjë lloj diskriminimi për shkak të orientimit të tyre seksual.

Pyetjes së dytë: “Prej kujt ndiheni më të diskriminuar?”, një e katërta e pjesëmarrësve i/u përgjigjën se diskriminimi vjen nga miqtë dhe njerëzit që i njohin. 20% ndjejnë diskriminim nga njerëzit e tyre më të afërt (familjarë dhe farefis), ndërsa 18% janë viktimat e diskriminimit nga ana e fqinjëve të tyre. Fakt interesant është se 13% e të anketuarëve ndjehen të diskriminuar nga persona të tjerë LGBTI. 10% thanë që kanë qenë të vënë në disavantazh nga kolegët e tyre, ndërsa 2% thanë që autoritetet janë diskriminuesi kryesor i tyre. 5% e të anketuarëve i zgjedhën të gjitha alternativat, ndërsa përqindje e njejtë e të anketuarëve thanë se nuk janë ndjerë të disfavorizuar për shkak të orientimit të tyre seksual.



Pyetja e tretë ishte: “Prej ku e merrni mbështetjen më të madhe, jashtë komunitetit LGBTI?”. Gati gjysma e të anketuarëve (47%) thanë që e gjejnë tek miqtë dhe të njohurit e tyre. Familjarët si njerëz të cilët mbështesin personat LGBTI janë zgjedhur nga 27% e të anketuarëve, ndërsa 22% kanë vendosur OJQ-ët të cilat punojnë për të drejtat e LGBTI-ve në këtë kategori. Vetëm 2% e të anketuarëve marrin afirmim nga organizata ose njerëz nga kultura e tyre, ndërsa 1% thanë që të gjitha grupet e lartpërmendura ju sigurojnë mbështetje të fuqishme. Është e rëndësishme të përmendet se Ministria për Punë dhe Politikë Sociale, si institucion përkatës i cili duhet të sigurojë një lloj mbështetjeje dhe sigurie personave LGBTI figuronte si opcion, por asnjëri nuk e zgjodi këtë mundësi si përgjigje.



Pyetjes së katërt: “Si mund të përmirësohet trajtimi i personave LGBTI?”, përqindja më e madhe (32%) mendojnë se mund të arrihet përmes reformave në arsim (me tërheqjen e teksteve shkollore homofobike; me arsimimin nga moshë më e re për të drejtat dhe liritë e njeriut; me futjen e arsimit seksual në shkollë...). Gati përqindja e njëjtë (31%) e shohin vetëdijësimin e opinionit si gjënë më të rëndësishme (përmes kampanjave, “coming out”-it publik të personave të famshëm, okupimit të hapësirave publike etj.). Një numër më i vogël i të anketuarëve (21%) mendon që trajtimi i personave LGBTI do të përmirësohet me futjen e rregulloreve ligjore (Ligji për Anti-Diskriminim, parandalimi i mobingut, mbrojtje shoqërore dhe shëndetësore për partnerët e personave LGBTI...). Vetëm 10% mendojnë se gjithçka do të bëhet më mirë nëse gjendja ekonomike në vend do të përmirësohet (do të ulët niveli i varfërisë dhe papunësisë, e me atë edhe varësia ekonomike ndaj familjes do të pushohet së egzistuari). 9% e të anketuarëve nuk mund të zgjidhnin një opcion të vetëm, andaj i zgjodhën të gjitha si njësoj të rëndësishme për përmirësimin e gjendjes së personave LGBTI.

Pyetjes: “Cilën nga këto të drejta të njeriut ti i sheh si më të rëndësishmet për personat LGBTI në Maqedoni?”, shumica e të anketuarëve (43%) thanë që është futja e orientimit seksual si bazë për diskriminim në “Ligjin për Anti-Diskriminim”. Ka 22% të cilët shohin mbrojtjen shoqërore dhe shëndetësore të partnerëve LGBTI si dobi më të madhe, ndërsa 17% mendojnë se është e drejta për martesë mes personave të të njejtit seks dhe familja. Parandalimi i mobingut do të ishte më i dobishmi për 8% të të anketuarëve, ndërsa 9% nga ata nuk mund të zgjidhnin vetëm një mundësi meqë i shohin të gjitha si njësoj të rëndësishme.




Një nga temat e fundit më të komentuar, lidhur me personat LGBTI në Maqedoni është përmendur në pyetjen e gjashtë: “A na nevojitet gej paradë?”. 60% u përgjigjën negativisht ndërsa 33% pozitivisht. 7%-ët e ngelur nuk kanë mendim rreth kësaj çështjeje.



Pyetja e shtatë: “Si do të bëhen personat LGBTI më të dukshëm në publik/opinion?” i bëri pjesëmarrësit mos të zgjidhnin vetëm njërën nga përgjigjet e ofruara. Dy nga gjërat më të rëndësishme me përqindje identike (30%) janë: “comig-out”(dalja hapur) para një rrethi më të gjërë dhe hapja e sa më shumë qendrave për promovimin e të drejtave dhe lirive të personave LGBTI. Gati 13% e të anketuarëve mendojnë se “coming out”(dalja hapur) përpara familjes është më e rëndësishmja, ndërsa 7% janë për hapjen e klubeve joformale LGBTI. 19% mendojnë se gjithçka e lartpërmendur është e rëndësishme bërë rritjen e dukshmërisë së personave LGBTI në publik.

Në pyetjen e tetë: “Si do të përforcohet komuniteti LGBTI, duke përdorur potencialet e veta?”, të anketuarëve i'u kërkohet që të jepnin vetë përgjigjen e tyre dhe mbase për shkak të karakterit të hapur të pyetjes, shumica e përgjigjeve ishin “Nuk e di! (47%). Nga zgjedhjet e selektuara, përqindja më e madhe (29%) mendojnë se antarët LGBTI duhet të jenë më të organizuar (më pak diskriminim mes vete; edukim i personave LGBTI; grupe mbështetje...). Dukshmëria më e madhe publike (kampanja, debate, akcione, gej parada) si një aspekt i rëndësishëm për përforcimin e komunitetit LGBTI u zgjodh nga 16% e të anketuarëve, përderisa vetëm 4% mendojnë “coming out” (dalja hapur) nga sa më shumë persona LGBTI do të përforconte komunitetin. Shumë pak nga ta, vetëm 2% mendojnë që potenciali i personave LGBTI është në marrjen më të madhe të hapsirës në media dhe në ushtrimin e ndikimit më të madh ndaj autoriteteve. Vetëm 2% mendojnë se aktualisht, komuniteti LGBTI është mjaftueshëm i fuqishëm dhe se nuk ka nevojë për shumë ndryshime.



Pyetjes së fundit: “Cili nga grupet e komunitetit LGBTI është më i diskriminuar?” ishte gjithashtu një pyetje e hapur dhe të anketuarit shkruan vetë përgjigjet. Gati gjysma e tyre (47%) u përgjigjën se janë personat transgjinjorë ata të cilët janë më të diskriminuar. Burrat gej si grup më i dëmtuar u zgjodh nga 19% e të anketuarëve, ndërsa përqindja e njejtë i shohin biseksualët (4%) dhe interseksualët (4%) si një grup të tillë. Lezbiket rezultojnë si grupi më pak i diskriminuar në komunitetin LGBTI. Edhe pse kërkohet që të zgjidhet vetëm një grup, 4% e të anketuarëve nuk bënë një gjë të tillë dhe thanë që të gjithë janë njëloj të diskriminuar, ndërsa 19% nuk kanë mendim rreth kësaj çështjeje.



Të përmbledhura, rezultatet nga sondazhi me një kampion (mostër) reprezentativ të personave LGBTI tregojnë se ata gati gati nuk e kanë idenë se si ti përforcojnë kapacitetet e komunitetit. Kërkesat e tyre janë të “thjeshta” dhe, siç tregojnë të dhënat ilustrative, përgjigjja më e shpeshtë është të shtohet “orientimi seksual” si bazë për mbrojtje kundër diskriminimit në ligj. Personat LGBTI janë të vetëdijshëm se integrimi më i mirë mes tyre çon në rezultate më të mira, por shumica e tyre nuk duan të ndërmarrin asgjë lidhur me këtë çështje në publik. Personat LGBTI i tremben publikut të gjërë, por nga ana tjetër “coming out-i” shihet si një nga prioritetet më të mëdhaja. Ngjajshëm, mbështetja më e madhe dhe diskriminimi më i madh vjen nga familjarët e tyre të afërt dhe miqtë. Personat LGBTI pajtohen njëzëri vetëm për faktin më dekurajues- që gati secili prej tyre ka qenë viktimë e ndonjë lloji diskriminimi.

Konkluzioni dhe rekomandimet

Hulumtimi ka treguar që fokusimi në prioritetet e menjëhershme të grupeve të caktuara brenda komunitetit LGBTI është i nevojshëm për përforcimin e tyre si një komunitet aktivist. Lezbiket dhe burrat gej nga etnitë e tjera shfaqën dhe sqaruan përvojat e tyre si grupe të marginalizuara brenda komunitetit LGBTI dhe shoqërisë më të gjërë. Nevoja për një intra-mobilizim (brenda për brenda) në nëngrupet specifike është treguar të jetë i nevojshëm dhe i mundur. Gjatë këtij projekti, përmes komunikimit të shpeshtë dhe debateve të organizuara me Qendrën për Mbështetjen e LGBTI-ve, IShShH-ja ka qenë dëshmitare e formimit të inicijativës LezFem dhe rritjes së përpjekjeve të personave gej nga pakicat e tjera për tu integruar më shumë në lëvizjen LGBTI. Duke u bazuar në debatet e hapura, inicijativave dhe të dhënave të mbledhura nga hulumtimi, IShShH-ja ju'a jep rekomandimet në vijim institucioneve përgjegjëse shtetërore:

1. Pikë së pari, “orientimi seksual” si bazë për mbrojtje kundër diskriminimit duhet patjetër të përfshihet në Ligjin për Anti-Diskriminim dhe në të gjitha strategjitë dhe ligjet e tjera të cilat garantojnë barazi mes të gjithë qytetarëve. Legjislativa duhet të përshtatet me standardet Evropiane duke përfshirë edhe rekomandimet nga OJQ-ët dhe ekspertët.
2. Duke synuar mbrojtjen e komunitetit LGBTI nga dhuna, duhet që të ketë tolerancë dhe ndërgjegjësim të diskursit publik. Duhet patjetër të hiqet dorë nga diskurset homofobike dhe në vend të tyre duhet të ketë një debat të hapur, modern, shoqërisht inkluziv (përfshirës) për të drejtat e LGBTI-ve.
3. Rekomandimet e lartëpërmendura nuk mund të zbatohen poqese opinion bërësit, mediat, nuk tregojnë ndjeshmëri ndaj personave LGBTI. Është rëndësishme sidomos, që mediat jo vetëm ti promovojnë këto vlera, por edhe të njoftojnë opinionin për fakte të caktuara të cilat do të parandalonin paragjykimet.
4. Ndalim dhe gjykim publik i gjuhës së urrejtjes (sidomos në media dhe Internet) duke përdorur ligje tashmë egzistuese që rregullojnë gjuhën e urrejtjes e cila mund të nxisë dhunë dhe diskriminim kundër personave LGBTI.
5. Futje e domosdoshme, në programet arsimore për shkollat fillore, e programeve të cilat do të parandalojnë paragjykimet dhe stereotipet ndaj personave LGBTI (trajnim për arsimtarët, arsimim seksual i përshtatshëm).
6. Rregullimi ligjor i statusit të personave transgjjinorë, në vend të interpretimit të lirë të zyrtarëve, sipas njohurive dhe bindjeve të tyre, gjatë kërkesave për ricaktimin e gjinisë dhe ndërrimin e dokumentave personale (letrave të njoftimit, numrit amëz, emrit).
7. Rritje e dukshmërisë për nevojat e posaçme të lezbikeve dhe personave gej nga etnitë e tjera duke ju mundësuar dispozita ligjore të veçanta dhe promovim të të drejtave të tyre, duke hartuar politika në fushën e mbrojtjes shëndetësore, mbrojtjes sociale, antidiskriminimit dhe mbrojtjes nga dhuna familjare.

Rekomandime për OJQ-ët të cilat punojnë për të drejtat e LGBTI dhe barazisë gjinore:

1. Përforcim i mardhënieve mes lëvizjes lezbike dhe lëvizjes për barazi gjinore si një hap i parë për integrim shoqëror dhe dukshmëri.
2. Përforcim i mardhënieve mes lëvizjes lezbike dhe lëvizjes për barazi gjinore për identifikimin e barazisë gjinore (“diskriminim si gra”) si komponentë e cila e përcakton/determinon diskriminimin si lezbike.
3. Autonomizim i lëvizjes lezbike në lëvizjen LGBTI me një mundësi për krijimin e hapsirës për të definuar prioritete të posaçme.
4. Përforcim i aktivizmit LGBTI për krijimin e komunitetit të burrave gej nga pakicat etnike dhe për intergimin e tyre më të madh në lëvizjen LGBTI, të përfaqësuar nga OJQ-ët me ndikim në vend.
5. Promovim i anti-nacionalizmit dhe inkluzionit etnik të personave LGBTI si model për solidaritet shoqëror që është i dobishëm jo vetëm për qëllimet në vetëvete, por që në të njëjtën kohe, arrin që të qëndroj mbi etnocentrizmin dhe nacionalizmin.
6. Përforcimi i komunitetit të personave transgjinorë brenda lëvizjes LGBTI, duke krijuar komunikim, besim dhe mbështetje e cila do të ndihmojë për përmirsimin e gjendjes së tanishme të vetë-izolimit të personave transgjinorë brenda lëvizjes.

Fundnota

¹Ligji për Parandalim dhe Mbrojtje nga Diskriminimi është në dispozicion në http://nkt.mtsp.gov.mk/nkt/content/Documents/anti_discrimination_law_mkd_2010.pdf

² Ligji për Mbrojtjen e të Drejtave të Pacientëve (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, Nr. 82 e 8 korrikut të vitit 2008), Neni 5 “Pacienti ka të drejtë mbi të drejtat e veta, të shkruara në këtë Ligj, pa u diskriminuar në bazë të gjinisë, racës, ngjyrës së lëkurës, gjuhës, fesë, bindjeve politike apo çfarëdo lloj bindjeve të tjera, origjinës kombëtare apo sociale, përkatësisë kombëtare, statusit material, origjinës së lindjes, orientimit seksual apo të çfarëdo statusi tjetër.”

³ Ligji për Shëndet Publik (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, Nr. 22 e 15 shkurtit të vitit 2010) në aktivitetet e Institutit për Shëndet Publik, Neni 16, “Instituti dhe Qendrat qeverisin aktivitetet e tyre në Nenin 10 dhe 11, bazuar në parimet e: 1) qëllim i definuar qartë i shëndetit publik; 2) proceduara të bazuara në parime dhe dëshmi shkencore moderne; 3) ndërhyrje të targetuara mirë që përfshijnë numrin optimal të personave në përputhshmëri me standardet e shëndetit publik; 4) bërjen e ndërhyrjeve që kufizojnë më së pakti të drejtat dhe interesat e individëve në shëndetin publik; 5) ndërmarrjen e ndërhyrjeve që nuk diskriminojnë individët në bazë të racës, seksit ose origjinës së ndryshme kombëtare dhe sociale ose statusit të pronës, besimit fetar, gjinisë, orientimit seksual ose statusit të një personi me nevoja të posaçme dhe 6) respektimi i dinjitetit të çdo individi gjatë ndërhyrjeve.”

⁴ Ligji për Arsim të Lartë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, Nr. 35 e 14 marsit të vitit 2008), Neni 108, “Univerziteti i përcakton procedurat për përzgjedhjen e kandidatëve pavarësisht racës, ngjyrës, seksit, gjuhës, fesë, bidjeve politike apo çfarëdo bidjesh të tjera, kombit, origjinës etnike ose sociale, pronës, lindjes, statusit shoqëror, paftësisë, orientimit seksual ose moshës.”

⁵Ligji për Shërbyes Publik (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, Nr. 133 e 30 shtatorit të vitit 2011), Neni 9, “Shërbyesi publik i trajton në mënyrë të barabartë personat juridik dhe fizik duke mos i diskriminuar personat fizik në bazë të moshës, origjinës etnike apo sociale, gjuhës apo racës, bindjeve politike, martesës ose statusit familjar, invaliditetit, orientimit seksual ose çfarëdo lloj baze tjetër, dhe personat juridik në bazë të llojit të tyre, fushës së shtrirjes, vendit të regjistrimit dhe shtetit të origjinës.”

⁶“Progres Raporti i 2011-ës për Ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë” është në dispozicion në http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2011/package/mk_rapport_2011_en.pdf, qasur më 20.07.2013.

⁷Progres Raporti i 2012-ës për Ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë” është në dispozicion në http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2012/package/mk_rapport_2012_en.pdf, qasur më 20.07.2013.

⁸“Konkluzionet për Ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë” është në dispozicion në http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2012/package/mk_conclusions_2012_en.pdf, qasur më 20.07.2013.

⁹“Rezultatet e IRJ e Maqedonisë në Hartën e Ylbertë të Evropës 2013”, është në dispozicion në http://www.ilga-europe.org/home/publications/reports_and_other_materials/rainbow_europe/score_sheet/fyr_macedonia, qasur më 20.07.2013.

¹⁰„Петрески: Не сум двоцевка во мене да се заљубува некој си Бандини“ [Petreski: Nuk jam biseksual që ndonjë Bandini të bhie në dashuri me mua] është në dispozicion në <http://a1on.mk/wordpress/archives/112618>, qasur më 16.07.2013.

¹¹„Ристовски: Нема да се дозволи склучување на хомосексуални бракови во Македонија“ [Ristovski: Nuk do të lejohetn martesa homoseksuale në Maqedoni] është në dispozicion në .

¹²„Владата ќе ги рекламира семејните вредности“ [Qeveria do të reklamojë vlerat familjare] është në dispozicion në <http://novatv.mk/index.php?navig=8&cat=2&vest=1017>, qasur më 20.07.2013.

¹³„22 Јуни - Датум за одржување на првата геј парада во Македонија“ [22 qershor- Data për mbajtjen e геј paradës së parë në Maqedoni] është në dispozicion në <http://www.sitel.com.mk/22-juni-datum-za-odrzhuvanje-na-prvata-gej-parada-vo-makedonija>, qasur më 16.07.2013.

¹⁴„КОНТРА-гејПАРАДА“ [“Kontra-Gej Paradë”) është në dispozicion në <https://www.facebook.com/events/598108286888440/>, qasur më 16.07.2013.

¹⁵Нападнат ЛГБТ центарот- повреден полицаец“[Është sulmuar Qendra LGBT- një polic është plagosur], është në dispozicion në <http://novatv.mk/index.php?navig=8&cat=2&vest=4946>, qasur më 16.07.2013.

¹⁶„Letër Kryeministrit të Maqedonisë“ është në dispozicion në <http://www.hrw.org/node/117037>, qasur më 16.07.2013.

¹⁷ „Соопштение по повод нападите во Скопје брз ЛГБТ заедницата“ [Kumtesë me rastin e sulmeve në Shkup ndaj komunitetit LGBT] është në dispozicion në <http://www.lp.org.mk/?p=2663>, qasur më 16.07.2013.

¹⁸ Åse Berit Grødeland, Perceptimet publike të organizatave joqeveritare në Serbi, Bosnje&Hercegovinë, dhe Maqedoni, Studime Komuniste dhe Post-Komuniste, Vëllimi 39, Botimi 2, qershor 2006, Faqet 221-246.

¹⁹ Pjesëmarrja e të miturve në këtë hulumtim nuk përputhej me qëllimet e projektit, sepse të intervistuarit flisnin për vizion dhe strategji aktivizi, që nënkupton nevojën për disa kompetenca të rriturish dhe kompetenca të tjera. Aktivistë LGBTI mbi 45 vjeç nuk ishin as të arritshëm për hulumtimin.

²⁰ Donna M. DeBlasio et al., Kapja e Tregimeve: Udhëzues Praktik për Histori Gojore. Swallow Press: 2009.



INSTITUTE OF
S O C I A L
S C I E N C E S A N D
H U M A N I T I E S
S K O P J E

Instituti i Shkencave Shoqërore
dhe Humane - Shkup

rr. 20 Tetori, nr.8. kati i dytë
1000 Shkup, Maqedoni

tel/fax: +389 2 3113 059
e-mail: info@isshs.edu.mk
www.isshs.edu.mk



Studimi njëvjeçar u realizua me ndihmën e Ambasadës së Mbretërisë së
Holandës në Republikën e Maqedonisë



Kingdom of the Netherlands

Puna e Institutit është e përkrahur nga Think Tank Fund - Budapest
dhe CIRa Civica Mobilitas

